

DEKRET

Nr. 10928, datë 5.11.2018

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të rregullave të parashikuara në nenin 9, paragrafi 1 dhe 2 dhe të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, në datën 30 qershor 2019.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**